

KËRKESË
Nr. 477/4, datë 27.4.2022

**PËR MARRJEN ME QIRA TË AMBIENTEVE PËR NEVOJA TË SISTEMIMIT
TË PUNONJËSVE TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT**

I. Kriteret ligjore që duhet të plotësojnë ofertuesit:

1. Kërkesë e ofertuesit për pjesëmarrje në konkurrim;
2. Të jenë titullarë të ligjshëm të pronës të vërtetuar me certifikate pronësie, lëshuar nga ASHK-ja, shoqëruar me kartelën e pasurisë, hartën treguese të pronës dhe gjenplanin;
3. Vërtetim hipotekar, që prona nuk është në sekuestro dhe është e lirë nga çdo barrë hipotekare apo detyrim tjetër ligjor, lëshuar nga ASHK-ja;
4. Vërtetim nga FSHU-ja, që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit të energjisë elektrike;
5. Vërtetim nga UKT-ja, që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit nga ujësjellës-kanalizimet;
6. Vërtetim që ofertuesi nuk është në ndjekje penale apo në proces gjyqësor;
7. Nëse është tregtar/shoqëri tregtare duhet të paraqesë edhe:
 - a) NIPT/NUIS, certifikatë të regjistrimit dhe ekstrat historik të regjistrimit të subjektit, që vërteton se ka status aktiv;
 - b) vërtetim nga tatim-taksat që nuk ka detyrime të pashlyera;
 - c) vërtetim që nuk ka sigurime shoqërore të pashlyera nga *e-Sigurime*;
 - d) vërtetim nga institucionet përkatëse, që subjekti apo përfaqësuesi ligjor i tij nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk është në proces gjyqësor në lidhje me aktivitetin;
 - e) në ofertën e tij, subjekti i interesuar duhet të japë të dhëna të sakta të personit të kontaktit;
8. Vetëdeklarim që ofertuesi nuk është në konflikt interesi me Kolegjin e Posaçëm të Apelit;
9. Vetëdeklarim për plotësimin e të gjitha kriterëve ligjore dhe kërkesave specifike të ambienteve që kërkohen nga Kolegji i Posaçëm i Apelit;
10. Kopje ID e titullarit të pronës/ambienteve;
11. Vërtetim të numrit të llogarisë bankare në një nga bankat e nivelit të dytë në RSH;
12. Ofertë me shkrim e çmimit të qirasë së ambienteve në muaj (veç kërkesave të tjera, oferta të jetë e nënshkruar nga administratori ose pronari i ambientit dhe të përmbajë të dhënat, sipas tabelës më poshtë):

Nr.	Emri dhe NIPT-i i subjektit	Përshkrimi	Sasia	Sip. totale në m ²	Çmimi pa TVSH (në lek)	Çmimi me TVSH (në lek)
1		Ambient me qira				

13. Oferta fituese do të jetë oferta me çmimin më të ulët (oferta ekonomike më e favorshme), e cila plotëson të gjitha kriteret ligjore dhe kërkesat e përcaktuara në njoftimin për marrjen e ambienteve me qira për zyra, për punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit;

14. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Kërkesat specifike të ambienteve objekt qiramarrjeje:

1. Ambient për zyra me sipërfaqe totale 120 m² - 150 m², ku duhet të përfshijë të paktën 3 ambiente për zyra dhe 1 tualet (të kompletuar me pajisjet hidrosanitare dhe pajisjet për ujë të ngrohtë);
2. Ambientet duhet të kenë të instaluar sistem vëzhgimi me kamera në hyrje të tyre;
3. Ambientet duhet të kenë furnizim me ujë dhe energji elektrike 24/7 dhe të jenë të pajisura me matës të dedikuar të ujit dhe energjisë elektrike;

4. Ambientet duhet të kenë sistem kondicionimi, të instaluar dhe plotësisht funksional;
5. Ambientet duhet të kenë rrjet interneti të instaluar, si dhe rrjetin e prizave të energjisë elektrike, për çdo post pune;
6. Ambientet duhet të jenë të përfunduara me dyer, dritare, të lyera dhe të gatshme/të lira për t'u shfrytëzuar nga qiramarrësi. Dera kryesore hyrëse në këto ambiente duhet të jetë me konstruksion metalik;
7. Ambientet duhet të jenë të pozicionuara brenda hapësirës që kufizohet nga veriu me rrugën "Myslym Shyri" dhe rrugën "Abdi Toptani", nga perëndimi me rrugën "Sami Frashëri", në lindje me rrugën "George W. Bush" dhe Rrugën e Elbasanit, në jug nga rruga "Abdyl Frashëri" dhe rruga "Dervish Hima";
8. Ambientet duhet të jenë boshe dhe të lira, dorëzimi i objektit do të bëhet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga njoftimi për lidhje kontrate;
9. Ofertuesi duhet të përcaktojë çmimin (oferta ekonomike), vlerën mujore të qirasë për një muaj, duke përfshirë të gjitha detyrimet tatimore, sipas legjislacionit në fuqi;
10. Paga e qirasë do bëhet çdo muaj në llogarinë në lekë të qiradhënësit, brenda datës që palët do të bien dakord në kontratën me shkrim, kundrejt lëshimit të faturës tatimore elektronike për subjektet tregtare. Në rast se qiradhënësi është individ dhe nuk mund të lëshojë faturë tatimore, paga e detyrimeve do të kryhet nga Kolegji i Posaçëm i Apëlimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për taksat dhe tatimet dhe shuma e detyrimeve do t'i zbritet qiradhënësit nga vlera e qirasë;
11. Afati i kontratës së qiradhënies të jetë jo më pak se një vit me të drejtë rinovimi. Afati do të përcaktohet gjithmonë nga qiramarrësi, i cili njofton me shkrim 30 ditë para mbarimit të kontratës qiradhënësin;
12. Detyrimet që lindin nga përdorimi i energjisë elektrike, ujit dhe internetit gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës së qirasë do të përmbushen nga Kolegji i Posaçëm i Apëlimit.

III. Paraqitja e dokumenteve dhe e ofertës së qirasë së ambienteve:

1. Dorëzimi i dokumenteve dhe i ofertës ekonomike duhet të bëhet brenda datës 11 maj 2022, ora 16:30, me postë ose dorazi, pranë institucionit të Kolegjit të Posaçëm të Apëlimit, në adresën: bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë.
2. Për çdo komunikim apo sqarim, ofertuesit mund të shkruajnë në adresën elektronike: info@kpa.al.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Laerta Rooze